



INFORMACIONE

SHTATOR - NËNTOR

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Tryeza e rumbullakët mbi strategjinë e zbatimit të programeve për Pekin 2008, Pescara 2009

CITIUS ALTIUS FORTIUS



Nga tryeza e rumbullakët mbi strategjinë e "Pekin 2008", "Pescara 2009"

KOKSH organizoi Tavolinën e Rumbullakët e aktorëve të pjesëmarrjes në "Almeria 2005", në "Tirana International" Hotel.

Me një pjesëmarrje të gjerë në prezantimin e hapur të vizionit të tij për strategjinë afatgjate, mbi diskutimin e objektivit: "Sporti Elitar Shqiptar 'Fitues i Medaljeve' apo 'Garues' në Lojrat Olimpikë? - nën drejtimin e personaliteteve të KOKSH, Presidentit Hysen Domi, Sekretarit të Përgjithshëm Stavri Bello; Shefit të Misionit Fidel Ylli, me praninë e Zv. Ministrit të MTKRS z. Neritan Alibali, zhvilloi punimet kjo tryezë, e cila shpalosi vizionin për pjesëmarrjen e Shqipërisë në "Pekin 2008".

Presidenti Domi u shpreh se "KOKSH është më se i impenjuar që të punojë bazuar mbi një

koncept strategjik, me theksin tek partneriteti ndërinstytucional, me vizionin "Pekin 2008".

Zv. Ministri Alibali (MTKRS) theksoi faktin se MTKRS në kuadër të një vlerësimi të aktualitetit, shprehet mbi ndërveprimin institucional, mbi vlera të partneritetit". MTKRS do të ketë në fokus rëndësinë dhe specifikat e sportit"

Në një analizë cilësore të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Lojrat Mesdhetare, u

diskutua nga përfaqësues të federatave dhe institucioneve sportive të cilët prezantuan një analizë specifike të çështjeve lidhur me Përfaqësimin në "Almeria 2005" dhe objektivat për të ardhmen.

Të ftuar në këtë tryezë, si aktorë të pjesëmarrjes së shqipërisë në "Almeria 2005" ishin: Komiteti Ekzekutiv dhe Komisioni Teknik i KOKSH; Qendra Kërkimore Shkencore e sportit; MTKRS: Drejtorja e Sportit Elitar; Federatat Pjesëmarrëse në "Almeria 2005"/ Presidentit & Sekretarit të Përgjithshëm; Trainerët pjesëmarrës.

Kjo analizë, do të përbëjë mundësitë e para të prezantimit me të gjithë aktorët, për realizimin e objektivit të mësipërm.

14 Shtator – KOKSH mundëson specializim 3 mujor të trainerit të Boksit

Engjellush Avdulaj është treneri, i cili me mundësimin e KOKSH dhe financuar nga Solidariteti Olimpik ka përfituar bursën 3 mujore nga programet e Solidaritetit Olimpik për kualifikimin e trajnerë në kuadër të mbështetjes së Federatave sportive dhe sportit në vecanti. Kjo bursë konsiston në një kurs 3 mujor në fushën e trainingut sportiv me specialitet boksit i cili organizohet nga Universiteti i Budapestit në Hungari.



Nga mbrojtja e temës në kursin "KOMPAS II"

7 Shtator - FSH Karate Karates KOKSH – MTKRS

Organizatorët e Kampionatit të 10^{te} Ballkanik të Karatesë, (zhvilluar për herë të parë në Shqipëri 11-13 Shtator 2005), Federata Shqiptare e Karates, KOKSH dhe MTKRS, në datën 7 Shtator, në Hotel "Tirana International" në Konferencën për Shtyp dhënë me këtë rast, informuan mbi përgatitjet dhe masat për organizimin me sukses të këtij evenimenti ballkanik. Në prani të medias dhe të anëtarëve të tjerë të komunitetit Sportiv por edhe të karatesë, djemve dhe vajzave të ekipit përfaqësues iu dorëzuan uniformat zyrtare të përfaqësimit.

Mbledhje e K.E. te KOKSH

Në Hotel Tirana Internacional, në datë 26 Shtator, Komiteti Ekzekutiv i KOKSH zhvilloi mbledhjen e tij të radhës. Sipas rendit të ditës, çështjet për diskutim ishin:

- Diskutime dhe miratime mbi aktivitetet e KOKSH për periudhën Shtator- Dhjetor 2005
- Procedurat për bursat Olimpike "Pekin 2005"
- Diskutim mbi pranimin e shoqatës Kombëtare të Sportit Universitar dhe Federatës së Boëling
- Diskutim mbi situatën në Federatën e Notit

Aktiviteti i Triatlonit

18 Shtator Inagurimi i Triatlonit në Shqipëri Për herë të parë në Shqipëri u inaguroa organizimi i garës së Triatlonit. Ky aktivitet që përfshin 3 sporte not, çiklizëm dhe atletikë, u organizua në qytetin e Durrësit në plazhin e golemit. Aktiviteti i iniciuar dhe sponsorizuar nga Louis Berger SAS u organizua me mbështetje të KOKSH, Federatës së Notit, Ciklizmit dhe Atletikës.



Pjesëmarrës në aktivitetin e "Triatlonit"

4 Tetor - Delegacioni i AIBA-s, vizitë në KOKSH

Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH priten në ambjentet e KOKSH për një vizitë pune delegacionin e Federatës Ndërkombëtare të Boksit (AIBAs) i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm i saj z. Caner Doganeli. Të pranishëm në takim ishin edhe Presidenti e Sekretari i Përgjithshëm i FSHBo.



Nga takimi në KOKSH me z. Doganeli



10 Tetor - Federata Europiane e Badmintonit në Shqipëri

I dërguari i Federatës Europiane të Badmintonit z. Horst Kullnigg i shoqëruar nga Mishel Pili, President i Komiteti Olimpik Rajonal Korçë, u pritën në një takim pune nga Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH. Qëllimi i takimit ishte interesimi i Federatës Europiane të Badmintonit në lidhje me paketën ligjore dhe kushtet e shqipërisë për të krijuar Federatën Shqiptare të Badmintonit.



Nga vizita e Fed. Europiane e Badmintonit në KOKSH

14-16 Tetor, COE seminar "Kujt i takojnë sportistët", të drejtat dhe detyrimet e NOC

Komisioni për bashkëpunim teknik dhe zhvillimit të sporteve i COE, organizoi në Lubjana të Sllovenisë, Seminarin e 6-të Teknik me temë:

"Kujt i takojnë sportistët", të drejtat dhe detyrimet e NOC. Ky seminar trajtoi një nga temat më të debatueshme sot në arenën ndërkombëtare sportive. Në këtë Seminar, nga Shqipëria morrën pjesë Sekretari i Përgjithshëm dhe kyetari i Komisionit Teknik të KOKSH.

7 Tetor - KOKSH - Bashkëpunim me Federatat, takim me FSHB dhe FSHV

Në kuadër të mbështetjes së Federatave Sportive për të konsoliduar brenda tyre sistemin e kualifikimit të vazhdueshëm të trajnerëve, në vecanti atyre të sporteve ekipore, KOKSH ka aplikuar pranë Solidaritetit Olimpik për të përfituar nga një projekt i cili konsiston në organizimin e Kurseve Teknike Kualifikuese 2 javore për trajnerë. Në këtë iniciativë, Komisioni i Kualifikimit të KOKSH ka vendosur që nga ky projekt të përfitojnë sporti i Basketbollit dhe Volejbollit. Në vijimësi të këtij projekti i cili është aprovuar tashmë nga Solidariteti Olimpik për të organiuar këto dy kurse brenda vitit 2005, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH ka zhvilluar një takim pune me Sekretarët e Përgjithshëm të FSHBs dhe FSHVs për të bashkëpunuar e marrë masat e duhura për organizimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për sportin shqiptar. Ky projekt konsiston në organizimin e një kursi dy javor për kualifikimin e trajnerëve të Basketbollit dhe Volejbollit, por qëllimi kryesor është që në këto Federata të vendoset kualifikimi i trajnerëve në strukturë.

28 Tetor KOKSH, CONI dhe Ambasada Italiane, Seminar: “Menaxhimi i infrastrukturës sportive”



Nga seminari: “Menaxhimi i infrastrukturës sportive”

I ftuar nga Italia Presidenti i komisionit të infrastrukturës sportive të CONI arkitekti dhe Ing. Franco Vollaro, KOKSH në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Shqipëri dhe me mbështetjen e CONI organizuan në Tirana International Hotel Seminarin me temë: “Menaxhimi i infrastrukturës sportive”. Seminari mbledhi sëbashku përfaqësues të MTKRS, specialistë të bashkive në rrethe, specialistë të infrastrukturës sportive publike dhe private të klubeve sportive, përfaqësues nga Kosova dhe Mali i zi. Temat të cilat u trajtuan në seminar ishin:

- *Ndërtimi dhe menaxhimi i impianteve sportive* – Ark. Franco Vollaro (CONI)
 - *Menaxhimi i Arena Fitness Center* – Denis Nuriu, sipermarrës privat
 - *Shfrytëzimi dhe menaxhimi i mjediseve sportive shtetërore dhe sipërmarrja private* – Prof.Asoc.Dr. Dhimitraq Skënderaj, AEFS “Vojo Kushi”
- Diskutimi nga pjesëmarrësit për problematikën në fjalë për evidentimin dhe njohjen e problemeve të infrastrukturës sportive në Shqipëri sic u shpreh edhe Presidenti i KOKSH z. Domi, ishte një nga pikat të cilat synoi organizimi i këtij seminari.

27-29 Tetor “Femra & Sporti”, CIO - Seminar ndër-rajonal

“Femra në sport” ishte tema kryesore e Seminarit ndër-rajonal i organizuar nga CIO me disa nga Komitetet Olimpikë të Europës jugore, në Stamboll të Turqisë. Ela Tase zv/Presidente e KOKSH dhe Majlinda Piliçi anëtare e Komisionit “Femra dhe Sporti”, morën pjesë në këtë seminar për përfaqësimin e KOKSH, ku dhe bënë një prezantim të shkurtër mbi rolin dhe nivelin e pjesëmarrjes së femrave në sport, në Shqipëri. Së shpejti ky seminar do të prezantohet në mbledhjen e rradhës së Komisionit “Femra dhe Sporti” të KOKSH.



Nga seminari: “Femra dhe Sporti” në Stamboll - Turqi

2 Nëntor Lojrat OLimpike Dimërore "Torino 2006"- Shqipëria merr pjesë për të parën herë

Kompetenca ekskluzive e Mundësimi të Pjesëmarrjes së një Shteti në Lojrat Olimpikë është një atribut ekskluziv i Komiteti Olimpik Kombëtar (Karta Olimpikë/ CIO).

Ky institucion (**KOKSH**)do të përmbushë procesin që mundëson për të parën herë në historinë e Lëvizjes Olimpikë dhe të Sportit Shqiptar, që Shqipëria të marrë pjesë në një Edicion të Lojrave Olimpikë Dimërore.

Skiatori 18 vjecar, djaloshi Erjon Tola, me të gjitha atributet zyrtare dhe cilësore, është kualifikuar, dhe do të ngrëjë flamurin Shqiptar në Ceremoninë e Hapjes së Lojrave Olimpikë në Torino 2006 (10-26 Shkurt 2006) . Kjo do të thotë që **Slalomi Gjigand do të njohë edhe Shqipërinë, ndërsa Shqipëria dhe Erjoni do t'i njohin vetes një moment të ri Historik.**

Lidhur me këtë eveniment për të promovuar këtë fakt si dhe përpjekjet që duhen bërë për një prezantim



Nga konferenca për shtyp "Torino 2006" KOKSH, FSH Ski

të parë për tu mbajtur gjatë në kujtesë, Presidenti i KOKSH, Sekretari i Përgjithshëm i tij dhe Presidenti i Federatës Shqiptare të Skive dhanë në ambjentet e KOKSH një konferencë për shtyp ku të pranishme ishin si mediat e shkruara dhe ato televizive.

Po këtë ditë titullarët e KOKSH dhe FSH Ski janë takuar dhe pritur në MTKRS nga zv/Ministri Alibali dhe përfaqësues të komunitetit të Biznesit për detaje dhe bisedime në mbështetje të pjesëmarrjes dhe të përgatitjes së Sportistit dhe Delegacionit Olimpik Shqiptar.

KOKSH po punon intensivisht që në bashkërendim me të gjithë partnerët të përgatitet drafti dhe aprovohet marrëveshja e palëve për financimin e buxhetit të nevojshëm të zërave të këtij procesi.

KOKSH ka kënaqësinë të promovojë interesimin direkt të **Coca Cola** dhe të Znj. Kristina Buzi, e cila me prezantimin e projekt buxhetit do të shprehet për mbështetjen që kjo kompani do të ofrojë për pjesëmarrjen e suksesëshme të Skiatorit Erion Tola në Lojrat Olimpikë "Torino 2006". **Coca Cola** është TOP Partner i CIO (Komiteti Olimpik Ndërkombëtar) dhe njëkohësisht gëzon të drejtat ekskluzive të njohjes së statusit si "**Worldwide Olympic Partner**" dhe i imazherisë së "**Torino 2006**".



Lojrat Olimpikë Dimërore "Torino 2006"

Zyrat e Administratës / COE financon Projektin e radhes te KOKSH

Zyrat e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Brenda vitit 2005 do të kenë një tjetër paraqitje, dhe kjo do t'i shërbejë më së miri funksionimit të mbarë të një administrate që punon me vizionin e standarteve bashkëkohore. Komiteti Olimpik European ka aprovuar projektin e pajisjes me kancelarite

dhe logjistiken e nevojshme te zyrave te KOKSH. Puna paraprake e bërë nga stafi i KOKSH, bashkëpunimi serioz i 3 prej kompanive më të mëdha në vend në fushën e mobiljeve të Zyrave dhe kancelarisë (AULIVIA, DROMEAS, GSA), Komisioni shqyrtues i ngritur me Urdhër të Presidentit të KOKSH, komunikimet e vazhdueshme me Sekretariatit e COE dhe vëmëndja e detajeve të mobilimit për lidhjen e kontratës me kompaninë e përzgjedhur, janë etapat që shoqërojnë rrugën drejt përfundimit me sukses dhe transparencës maksimale të projektit.

10 Nëntor – Projekti i Bursave Olimpikë “Pekin 2008” Promovohet APLIKIMI



Nga takimi me Federatat, Bursat Olimpikë Pekin 2008

Përfaqësues Zyrtarë të Federatave Kombëtare Sportive (Të sporteve Individuale- sipas specifikave të CIO) të cilave u ofrohet mundësia të aplikojnë për përfitimin e bursave Olimpikë, ishte të pranishëm në prezantimin e bërë nga Titullarët e KOKSH lidhur me: Udhëzimet dhe formatet e nevojshëm për aplikimin për kandidim të kandidatëve të Federatës për Programin e Solidariteti Olimpik të Bursave “PEKIN 2008”. Presidenti Domi theksoi se “Është i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë dhe i vemendshëm mes Federatës Kombëtare Sportive (me vetë strukturat e saj) dhe me KOKSH për suksesin në secilën fazë të Projektit”.

Projekti përbëhet nga 4 Faza (Udhëzimet vijuese kane te bejne me fazen e pare ‘ KANDIDIMI’:

Aplikim për Kandidim - Aprovimi nga CIO- Zbatimi – Lojrat Olimpikë “PEKIN 2008”

Solidariteti Olimpik ofron me anë të këtij programi, një ndihmë të zgjeruar individuale të sportistëve që stërvitën dhe tentojnë të kualifikohen, për Lojrat e XXIX-ta Olimpikë në Pekin.

Programi i Bursave Olimpikë është ofruar nga Solidariteti Olimpik që prej Lojrave Olimpikë në Barcelonë, dhe është punuar në mënyrë konstante për rinovimin e tij në përshtatje me nevojat në ndryshim të Komiteteve Olimpikë Kombëtarë. Në shpresojmë që edicioni i Pekin 2008-ës i këtij programi do të mund të jetë një ndihmë në përgatitjen e sportistëve tanë më të mirë për edicionin e ardhshëm të këtyre Lojrave Olimpikë. KOKSH do të jetë në pritje të kandidaturave të federatave në përputhje me të gjitha këkresat dhe dokumentacionet e shprehura më shkrim në dosjen dokument e cila iu dorëzua federatave përkatëse. I tërë procesi i projektit të Bursave Olimpikë do të jetë i hapur për median dhe publikun.

Sekretari i Përgjithshëm Stavri Bello, bëri me dije se këto bursa do të jenë të dedikuara për Sportistin që do të fitojë, dhe Partnerët Institucionalë duhet të kontribuojnë në zërat e tjërë të Trainerit, Përgatitjes Fizike, asistencë mjekësore dhe shëndetësore, MTKRS – QKSH – Federatë – Partnerë Biznesi”.

Pas mbledhjes Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, dolën në një konferencë për shtyp në të cilën informuan në lidhje me projektin, për mënyrën e aplikimit dhe përfitimit të bursave Olimpikë nga federatat sportive.

11 Nëntor – Mbledhje e Komisionit Sporti për të Gjithë

Ditën e Premte të datës 11 Nëntor, në ambientet e KOKSH, Komisioni i “Sporti për të Gjithë” të KOKSH, zhvilloi mbledhjen e dytë të tij për këtë vit. I kryesuar nga kryetari i saj z. Ilija Gaxho dhe në prani të pothuajse të gjithë anëtarëve të komisionit, rendi i mbledhjes për diskutim ishte:

- Aplikimi për aktivitetin polisportiv-ndërkufitar nën patronazhin e CIO
- Deklarata e Kongresit të 10-të

Botëror të “Sportit për të Gjithë” i zhvilluar në Romë, Itali.

- Vizione aktuale dhe perspektive të Sportit për të Gjithë të KOKSH



Nga mbledhja e Komis. “Sporti për të Gjithë”

- Diskutim për realizimin e një tryeze të rrumbullakët në shkallë kombëtare, në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe ato private, për të gjitha aspektet e “Sportit për të Gjithë” në Shqipëri.

Aktivite nga Federatat sportive

FSHM

Kampionati Kombëtar i Mundjes Greko Romake dhe e lirë

Më datën 23 Shtator, në Pallatin e Sportit "Asllan Rusi", u zhvillua Kampionati Kombëtar i Mundjes për të rritur – stili Greko-Romak. Në të morrën pjesë ekipi Dinamos, Besëlidhja A, Flamurtari dhe Partizani A i cili u shpall edhe ekipi kampion. Ndërsa në datën 30 Shtator po në e Sportit "Asllan Rusi", u zhvillua Kampionati Kombëtar i Mundjes së lirë për të rritur ku morrën pjesë 7 ekipe. Sportisti Elis Guri + 96kg ne stilin greko-romak dhe Gentian Geraj 66kg shpallen sportistët më të mirë të aktivitetit. Sportistët kampionë sipas kategorive të peshave janë:

Kampionët sipas peshave

Greko-Romake

55 kg Ermal Mata
60 kg Ervin Mata
66 kg Denis Nuriu
74 kg Leonard Zeneli
84 kg Ergys Mirukaj
96 kg Klodian Koci
+96 kg Elis Guri

Mundje e Lire

Elidon Demaj
Klodian Tereziu
Gentian Geraj
Ermal Kryeziu
Leonaerd Cakmashi
Roland Tusha
Fatjon Baro

FSHP

Peshëngritësit Shqiptarë në Kampionatin European për të Rinjë në Sllovaki.

Sukses i madh për sportistët e rinjë të peshëngritjes. Në muajin Tetor 2005 ekipi kombëtar i peshëngritjes për të rinjë, mori pjesë në Kampionatin European për të Rinjë e të Reja në Trecin, Sllovaki. Me një ekip të kompletuar dhe me ambicje për fitore dhe rekorde, ekipi shqiptar i arriti të fitojë me meritë 5 medalje ari, 7 argjendi 3 bronzi dhe të thyejë 3 rekorde Europiane. Fituesit e medaljeve janë:

Medalistët në Kampionatin European

Sportistët

Medalje

Fetije Kasaj	3 Ari
Gerta Suli	1 Argjendi; 2 Bronzi
Romela Begaj	2 Argjendi
Arjon Breshanaj	1 Bronzi
Gert Trasha	2 Ari; 1 Argjendi; dhe 1 rekord european
Erkand Qerimaj	2 Argjendi; 2 rekorde europiane
Endri Haxhihyseni	1 Argjendi

FSHJ

JUDO – Kampionati i 5-të mbarëkombëtar për të rritur femra dhe meshkuj


Federata Shqiptare e Judos, më datë 23 Tetor 2005, në pallatin e sportit "Qazim Dervishi" të qytetit të Shkodrës, ka organizuar Kampionatin e 5-të Mbarëkombëtar për të rritur femra dhe meshkuj. Në këtë veprimtari morrën pjesë 41 meshkuj dhe 15 femra, ndërsa ekipet pjesëmarrëse ishin Shqipëria, Kosova, Diaspora dhe Shqiptarët e Maqedonisë. Ekipi Kosovar u shpall dhe ekipi më i mirë.



Nga Kampionati Mbarëkombëtar i JUDO-s, Shkodër

KOKSH dhe epoka dixhitale e sportit Shqiptar

Në vazhden e projekteve të KOKSH të financuar nga Solidariteti Olimpik, një nga projektet më të fundit dhe më abicioz të KOKSH, ka të bëjë me ruajtjen në mënyrë dixhitale të të gjithë arkivave të KOKSH të formateve të ndryshme, si ato video (filmike), audio, fotografike, dokumenta të ndryshme kompjuterike, etj. Ky është një projekt të cilin Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (CIO) ua ofron të gjitha Komiteteve Olimpike Kombëtare me qëllim që të ruajnë dhe pasurojnë arkivat e tyre dhe ti vënë në funksionim ato për edukimin e brezave të rinj, sportistëve dhe të jenë një burim i sigurt për studiuesit dhe kërkuesit e sportit. KOKSH nëpërmjet këtij projekti synon që të gjitha materialet që do të ruhen në këtë sistem dixhital, materiale të cilat i kemi dhe por edhe ato që nuk i disponojmë si flimime, foto e dokumentacione të ndryshme të pjesmarrjes së Shqipërisë në Lojrat Olimpike të "Mynich 1972", "Barcelona '92", etj, të cilat KOKSH do ti sigurojë nëpërmjet CIOs, do të jenë baza materiale kryesore për ngritjen një Muzeu Olimpik dhe historik të sportit Shqiptar. Kjo arkivë do tu vihet në dispozicion të gjitha federatave dhe shoqatave sportive dhe gjithashtu do t'iu jepet mundësia që të ruajnë edhe ato arkivat e tyre në mënyrë dixhitale. Qëllimi kryesor i dixhitalizimit të arkivave të sportit shqiptar nuk është thjesht ruajtja e tyre, por, në perspektivë për të krijuar një muze historik, ato do t'i shërbejnë edhe krijimit të një kulture sportive.



Sistemi i arkivimit dixhital - nga EDUSOFT

Urim Zëvendës Presidentit të KOKSH, z. Genc Ruli



Genc Ruli

Ministër i Ekonomisë dhe Energjitikës në qeverinë e re të formuar pas zgjedhjeve të 3 Korrikut 2005 zoti Genc Ruli, prej kohësh Zv/Presidenti i KOKSH.

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar i uron z. Ruli sukses në përmbushje të detyrës së tij. Për Lëvizjen Olimpike Shqiptare është një kënaqësi më shumë dhe një moment i vecantë ky fakt.

Këndi i falenderimeve

Falënderim firmës **AGFA Studio Design** për shërbimin falas të dizenjimit dhe nxjerrjes së filmave të buletinit informativ të KOKSH.

KOKSH gjatë muajit tetor organizoi konkursin për projektin e mobilimit të zyrave të institucionit. Një projekt i mbështetur nga Komiteti Olimpik European në Romë. Në këtë botim, KOKSH dëshiron të falënderojë për profesiona-lizmin dhe përgjegjësinë të tre kompanitë e përfshira në këtë konkurs, "Dromeas", "Aulivia" dhe "GSA" duke iu uruar mbarësi të mëtejshme në biznesin e tyre.

Falenderim Gazetës Sport Ekspres KOKSH organizon projekte të shumanshëm për të cilat është e nevojshme që publiku i komunitetit sportive t'i bëhet me dije që të mund të jetë pjesëmarrës. KOKSH dëshiron të shprehë vlerësimin ndaj Gazetës "Sport Ekspres" dhe Kryeredaktorit për gatishmërinë në pasqyrimin e njoftimeve të KOKSH.

President: Hysen Domi
Sek i Përgjithshëm: Stavri Bello

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Rruga: "Muhamet Gjollësia", 21 Dhjetori - Tel. +355 235249/240602 - Fax.+355 240565 E-mail:secretariat@nocalbania.org.al - www.nocalbania.org.al